



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**

**ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT**  
**TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE**  
**PROCUREMENT REVIEW BODY**



**PSH .nr.912/19**

**PANELI SHQYRTUES**, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje të: z. Goran Milenković - Kryetar, z. Nuhi Paçarizi– Referues, z. Blerim Dina - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik: OE Ntsh “AtomMed” - Ferizaj, kundër njoftimit për kontratë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Furnizimi me pajisje mjekësore për fizioterapi dhe laborator për nevoja të QKMF-së-Ri-tenderim LOT2” me nr. të prokurimit: 623-19-9204-1-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ – Kuvendi Komunal Rahovec, më datën: 15.01.2020, mori këtë:

**V E N D I M**

**I. APROVOHET**, si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik Ntsh “AtomMed”, për aktivitetin e prokurimit: “Furnizimi me pajisje mjekësore për fizioterapi dhe laborator për nevoja të QKMF-së-Ri-tenderim LOT2” me nr. të prokurimit: 623-19-9204-1-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ – Kuvendi Komunal Rahovec

**II. ANULOHET**, njoftimi për kontratë dhe anulohet në tërësi aktiviteti i prokurimit me titull: “Furnizimi me pajisje mjekësore për fizioterapi dhe laborator për nevoja të QKMF-së-Ri-tenderim LOT2” me nr. të prokurimit: 623-19-9204-1-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ – Kuvendi Komunal Rahovec.

**III.** Autoriteti Kontraktues në afat prej **10** ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

**IV.** Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues: Ntsh “AtomMed”- Ferizaj,aprovohet si e bazuar, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 33 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

## A R S Y E T I M

Sqarim rreth inicialeve për procesin e prokurimit :

Autoriteti kontraktues në tekstin e më poshtëm AK ;

Operatori ekonomik në tekstin e më poshtëm OE ;

Dosja e Tenderit në tekstin e më poshtëm DT ;

Njoftimi për Kontratë në tekstin e më poshtëm NJpK ;

Ligji për Prokurim Publik-në tekstin e më poshtëm LPP;

Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurim Publike në tekstin e më poshtëm- RRUOPP;

Komisioni Rregullativ për Prokurim Publik , në tekstin e më poshtëm – KRPP;

Organi Shqyrtues i Prokurimit në tekstin e më poshtëm-OSHP;

Paneli shqyrtues në tekstin e më poshtëm – PSH;

Operatori ekonomik ankues OE: Ntsh “AtomMed”- Ferizaj, si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, me 12.12.2019 me nr. 912/ 19, kundër njoftimit për kontratë , lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Furnizimi me pajisje mjekësore për fizioterapi dhe laborator për nevoja të QKMF-së-Ri-tenderim LOT2” me nr. të prokurimit: 623-19-9204-1-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ – Kuvendi Komunal Rahovec”, duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin: 1,6,7 dhe 28 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës si dhe nenet 18.9 dhe 20 i RROUPP-së.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 17.12.2019, ka autorizuar ekspertin profesional të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.



Eksperti profesional i prokurimit në raportin e dt: 26.12.2019, ka dhen konstatimet ne te gjitha pretendimet ankimore te OE ankues si në vijim:

Përgjigje ne pretendimet ankimore te OE "Ntsh "AtomMed"-Ferizaj –

#### **Përgjigje në Pretendimi nr.1**

Lidhur me pretendimin e OE ankues, se AK ka bërë shkelje të nenit 1, 6, 7 dhe 28 të LPP-së si dhe nenin 18.9 dhe 20 të RrUOPP-së, me arsyetimin se:

“AK Komuna Rahovec për **Lot 2** më dt. 29.11.2019, për këtë aktivitet të prokurimit ka publikuar Njoftimin për Kontratë në platformën e elektronikë, me ç ‘rast ne kemi qe në të interesuar që të ofertojmë, por kemi hasur në specifikime teknike të cilat janë diskriminues se dhe favorizuese.

Autoriteti kontraktues ka përdorur specifikimet teknike që i janë përshtatur prodhuesit Dialabnga Austria, me përfaqësueset një në Kosovë dhe pikërisht për pajisjen AUTLYSER.

Në katalogun e pajisjes që ne kemi dhe ne si dëshmi që favorizon këtë OE apo prodhues(do të mund të gjendet në këtë uebfaqe

<https://www.dialab.at/nc/en/products/instruments/instrument/clinical-analysers/autolyser-ise/dhe> që mund të verifikohet lehte), kemi vendosur me numra se kumundtighenitedetajizuaraspecifikimetqepërmbajnënumrapërtianalizuar. Kur këto specifikimet i përkthejmë në gjuhën Shqipe, del se çdo rreshti specifikacioneve teknike është i përshtatur 100%.

Përshtatja e specifikimeve dhe kërkesave teknike është në kundërshtim me nenin 28 paragrafi 2 të LPP-së, dhe nenin 20 të RRUOPP, ku "Autoriteti kontraktues do ti përpiloje specifikimet teknike në atë mënyrë që ato të jenë në përputhje me qëllimin e prokurimitdhetëdrejtuaradrejtisigurimittëqasjessamëtëmirepërtëgjithëoperatorët e interesuar ekonomik dhe tenderuesit. Autoriteti kontraktues është veçanërisht i ndaluar që të hartojë specifikime teknike që favorizojnë ose diskriminojnë një ose më shumë operatorë ekonomik. Si dhe specifikimet teknike do të përshkruajnë dhe për kufizojnë, në mënyrë jo diskriminuese, karakteristikat e obligueshme të objektit të kontratës, siç janë cilësia, performanca, kërkesat e dizajnit, dimensionet, siguria, sigurimi i cilësisë, terminologjia, simbolet, testimi dhe metodat e testimit, paketimi, shënimi dhe etiketimit, duke i bërë të qartë a, sakta dhe precize dhe duhet të mos paraqet kufizime të panevojshme, në mënyrë që të mos kufizohet konkurrenca Po ashtu autoritetit kontraktues i ndalohet të përpilojë specifikimet teknike që i referohen një artikulli ose burimi të veçantë, ose një procesit hollësishëm, ose ndonjë shenje dalluese, Lloji ose origiine të veçantë ose ndonjë prodhimi.

Madje edhe parimi direktivave të BE-së, është se: "Specifikimet teknike do të ofrojnë qasje të barabartë për tenderuesit dhe nuk duhet të kenë efektin e krijimit të pengesave të paarsyeshme në hapjen e konkurrencës së prokurimit publik."

Gjithashtu neni 18.9 i RRUOPP-së përcakton qartë "Dosja e tenderit do të përgatitet në mënyrë që nuk:

- Kufizon konkurrencën në mesin e OE, ose
- Diskriminon kundër ose vepron në favor të një ose me shumë OE-ve.

Atëherë, ne kemi bere më dt.05.12.2019, brenda afatit ligjor të parashtrojmë përmes Kërkesës për rishqyrtim pranë autoritetit kontraktues, pretendimet tona ankimore, duke kërkuar nga autoriteti kontraktues që të ndërmarrë veprimet ligjore të nevojshme dhe të eliminojë lëshimet apo shkeljet ligjore që janë në kundërshtim me dispozitat e Prokurimit Publik. Lidhur me këtë kërkesë në për rishqyrtim autoriteti kontraktues nxjerrë vendim më dt.06.12.2019, kur refuzon kërkesën tone site pa bazuar, duke u arsyetuar se AK ka vepruar konform LPP-së.

Vlen të theksohet fakti se Komuna Rahovec për këtë aktivitet te prokurimit, për të njëjtat pajisje ka pasur tenderi paraprake cilin e ka shpallur dt. 31.07.2019, me titull te njëjtë FURNIZIM ME PAJISJE MJEKËSORE PER FIZIOTERAPI DHE LABORATOR PER NEVOJA TË QKMF-së, dhe nr. të. Prokurimit: 623-19-5608-1-2-1, kumë pastaj është anuluar pikërisht pas kërkesës tone për rishqyrtim lidhur me pretendimet tona të njëjtadhe konstatim të tyre për specifikime diskriminuese për LOT 2: FURNIZIM ME PAJISJE MJEKËSORE PER LABORATOR PER NEVOJA TË QKMF - së. Komuna Rahovec po të njëjtin aktivitet e ka bërë ri-shpalljen me specifikimet teknike të njëjta dhe diskriminuese.

Autoriteti Kontraktues Kuvendi Komunal Rahovec me datën 08.10.2019 ne sistemin elektronik e-prokurimi ka bere Njoftimin për Kontratë për te njëjtin aktivitet për tenderin me Titull: FURNIZIM ME PAJISJE MJEKËSORE PER FIZIOTERAPI DHE LABORATOR PER NEVOJA TE QKMF-se- RITENDERIM nr te prokurimit 62319-7651-1-2-1 për LOT 2: FURNIZIM ME PAJISJE MJEKËSORE PER LABORATOR PER NEVOJA TË QKMF-, pas te gjithë hapave ligjor ne kemi deponuar pran OSHP-se me datën 22.10.2019 ANKESE-ne tone lidhur me shkeljet e Autoritetit Kontraktues lidhur me pretendimet tona.

Me datën: 04.11.2019 OSHP-sjell Vendim me nr. 730/19 ku vjen ne përfundim ku:

\*Ankesa jone është vlerësuar e Bazuar dhe kërkohet nga Autoriteti Kontraktues qe te beje ANULIMIN e Aktivitetit te prokurimit dhe te hartoj specifika teknike konform LPP-se duke krijuar mundësi sa me te mire për te gjithë Operatorët e interesuar Ekonomik dhe tenderuesit.



Me datën 29.11.2019 Autoriteti Kontraktues KUVENDI KOMUNAL RAHOVEC, bene publikimin e njoftimit për Kontratë Lidhur me te njëjtin Aktivitet të prokurimit për tenderin me Titull: FURNIZIM ME PAISJE MJEKESORE PER FIZIOTERAPI DHE LABORATOR PER NEVOJA TE QKMF-se-RITENDERIM, me nr. të prokurimit: 623-19-9204-1-2-1, me nr. të brendshëm 623-19-064-1-2-1 për LOT 2: FURNIZIM ME PAJISJE MJEKËSORE PER LABORATOR PER NEVOJA TË QKMF.

Pas shikimi të detajuar të Specifikave Teknike të publikuara në kemi hasur në parregullsitë e njëjta siç kanë qenë në 2 aktivitetet paraprak lidhur me Specifikat Favorizuese dhe Diskriminuese.

Autoriteti Kontraktues në këtë Rast Komuna e Rahovecit, nuk ka bërë NDRYSHIME-apo dhe Gjeneralizim të Specifikave Teknike por ato që kanë qenë në aktivitetet paraprake me disa dallime minimale që nuk përmban ndryshimi ka publikuar serish në këtë aktivitet.”

duke u bazuar në faktet e gjetura me rastin e trajtimit të lëndës eksperti shqyrtues konstaton se pretendimet e operatorit ekonomik ankues **janë të bazuara** sepse AK me rastin e ri tenderimit të këtij aktiviteti të prokurimit pas njoftimit të PSH 730/19 datës 04.11.2019 me të cilin është kërkuar nga AK që ky aktivitet të ri tenderohet dhe specifikat e tenderit të korrigjohen konform LPP-së, AK me rastin e ri tenderimit në këtë aktivitet të prokurimit ka korrigjuar specifikat teknike lidhur me LOT 2: Furnizim me pajisje mjekësore për laborator për nevojat të QKMF-së” vetëm në disa pika si vijon:

**Në tabel janë përshkruar shkurtimisht vetëm specifikat e reja(korrigjuara) dhe specifikat e vjetra:**

<b>Specifikat e reja</b> (pjesa e korigjuara)	<b>Specifikat e vjetra</b> (si kanë qenë në procedurën e kaluar)
Perputhje deri në 440 teste/h	Perputhje deri në 450 teste/h
Perputhje I.S.E only 195 testes/h Throughput Chemistry + I.S.E: 245 testes/h	Perputhje I.S.E only 200 testes/h Throughput Chemistry + I.S.E: 250 testes/h
Profili deri në 480 teste në memorie	Profili deri në 500 teste në memorie
Sirtari i reaguesit-min 23 max 26 pozicioni	Sirtari i reaguesit-24 pozicioni
Sirtari i mostres-min 58 max 62 pozicioni	Sirtari i mostres-62 pozicioni
Koha e llambes rreth min 1800 orë	Koha e llambes rreth 2000 orë
6 min GB DD R4 2400 MHZ	8 min GB DD R4 2400 MHZ

ndërsa pjesa tjetër e specifikave teknike të përshkruara në dosjen e tenderit të këtij aktivitetit të prokurimit janë identike me specifikacionin i cili ka qenë në dosjen e tenderit të aktivitetit të prokurimit i cili është anuluar me qëllim që të korrigjohen specifikat teknike.

Duke u bazuar në faktet e lartë cekura eksperti shqyrtues konstaton se AK ka bërë disa korrigjime te specifikacioneve por te cilat janë vetëm korrigjime minore sepse përsëri komplet specifikacioni teknik respektivisht po thuhet mbi 90% e këtyre specifikavetëknike janë identike me specifikat e paisjes “Dialab Autolyser ISE” të kompanisë prodhuese “DIALAB” me adresë “Gesellschaft m.b.H. IZ NOE-Sued Hondastraße, Objekt M55, A-2351 Wr. Neudorf, **Austria**”.

Përveç fakteve të bashkangjitura me këtë ankesë nga OE ankuese për specifikat e paisjes “Dialab Autolyser ISE” eksperti shqyrtues sqaron se ka bërë hulumtimin/verifikimin e specifikacionit në fjalë edhe përmes adresave elektronike: <https://www.dialab.at/en/products/instruments/clinical-analysers/autolyser-ise/>, si dhe <https://www.dialab.at/en/en/products/instruments/instrument/clinical-analysers/autolyserise/>, ku pas qasjes në këto adresa është konstatuar se specifikacioni teknik i paisjes “Dialab Autolyser ISE” është mbi 90% identik me specifikacionin teknik të përshkruar nga AK për paisjen mjekësore për laborator për nevoja të QKMF-së”.

Hartimi i specifikacionit teknik nga AK në rastin konkretë duke pas parasysh interesimin e pjesëmarrjes të OE ankuese në këtë aktivitet të prokurimit, është në kundërshtim me paragrafin 2 te nenit 28 ku thuhet se: “Autoriteti kontraktues do t’i përpilojë specifikimet teknike në atë mënyrë që ato të jenë në përputhje me qëllimin e prokurimit dhe të drejtuara drejt sigurimit të qasjes sa më të mirë për të gjithë operatorët e interesuar ekonomik dhe tenderuesit. Autoriteti kontraktues është veçanërisht i ndaluar që të hartojë specifikime teknike që favorizojnë ose diskriminojnë një ose më shumë operatorë ekonomik”.

Si dhe në kundërshtim me paragrafin 20.4 të RRUOPP ku thuhet: “Specifikimet /TER do të jetë e qartë, e saktë dhe precize dhe duhet të mos paraqet kufizime të panevojshme, në mënyrë që të mos kufizohet konkurrenca. Ato duhet të përkufizohen në mënyrë që mos të krijojnë dyshime rreth natyrës së mallrave, punëve ose shërbimeve të kërkuara”.

Po ashtu eksperti shqyrtues konstaton se AK nuk e ka zbatuar ne tersi rekomandimin e panelit shqyrtues te dhen me njoftimi PSH nr.730/19 te datës 04.11.2019.

Mendimi i ekspertit profesional: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa me nr. 912/19 dt.12.12.2019eOE Ntsh “AtomMed”-Ferizaj, të aprovohet si e bazuar (për arsyeje që u ceken tek përgjigjet në pretendimet e ankesës), si dhe rekomandon që njoftimi për kontratë i AK-së të **Anullohet** me qëllim që AK të ndryshoj respektivisht hartoj specifikimet teknike konform LPP-së duke krijuar mundësi dhe qasje sa më të mirë për të gjithë operatorët e interesuar ekonomik dhe tenderuesit.



Autoriteti Kontraktues përmes parashtresës me shkrim të datës: 27.12.2019, ka njoftuar OSHP-në se nuk pajtohet me raportin e ekspertit profesionale, po ashtu edhe Operatori ekonomik përmes parashtresës me shkrim të datës: 27.12.2019, ka njoftuar OSHP-në se pajtohet me raportin e ekspertit profesionale,

Seanca dëgjimore është mbajtur me datën: 15.01.2020, pa praninë e palëve konform nenit 26.1 të Rregullores së OSHP-së, e ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi për dhënie të kontratës, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit profesional të prokurimit, dhe të gjithë parashtresat e palëve në procedurë.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues/teknik deklarimit të palëve në procedurë, diskutimeve dhe shoshitjes së provave në tërësi gjatë seancës për shqyrtim kryesor, sqaron se ankesa është parashtruar kundër njoftimit për kontratë (në kritere të DT).

Lidhur me pretendimin e OE ankues, se AK ka bërë shkelje të nenit 1, 6, 7 dhe 28 të LPP-së si dhe nenin 18.9 dhe 20 të RrUOPP-së, sepse “AK Komuna Rahovec për Lot 2 më dt. 29.11.2019, për këtë aktivitet të prokurimit ka publikuar Njoftimin për Kontratë në platformën e elektronikë, me ç’ rast ne kemi qenë të interesuar që të ofertojmë, por kemi hasur në specifikime teknike të cilat janë diskriminues dhe favorizuese.

Autoriteti kontraktues ka përdorur specifikimet teknike që i janë përshtatur prodhuesit Dialab nga Austria, me përfaqësueset një në Kosovë dhe pikërisht për pajisjen AUTLYSER.

Në katalogun e pajisjes që ne kemi dhënë si dëshmi që favorizon këtë OE apo prodhues (do të mund të gjendet në këtë ueb faqe <https://www.dialab.at/en/products/instruments/instrument/clinical-analysers/autolyser-ise/> dhe që mund të verifikohet lehtë), kemi vendosur me numra se ku mund ti gjeni te detajizuara specifikimet që përmbajnë numra për ti analizuar. Kur këto specifikimet i përkthejmë në gjuhën Shqipe, del se çdo rreshti specifikacioneve teknike është i përshtatur 100%.

Më tej vazhdon ankuesi se vlen të theksohet fakti se Komuna Rahovec për këtë aktivitet të prokurimit, për të njëjtat pajisje ka pasur tenderi paraprake cilin e ka shpallur dt. 31.07.2019, me titull të njëjtë “Furnizim me pajisje mjekësore për fizioterapi dhe laborator për nevojat e QKMF-së”, me nr. të.



Prokurimit: 623-19-5608-1-2-1, ku më pastaj është anuluar pikërisht pas kërkesës tone për rishqyrtim lidhur me pretendimet tona të njëjta dhe konstatimit të tyre për specifikime diskriminues për LOT 2: "Furnizim me pajisje mjekësore për fizioterapi dhe laborator për nevojat e QKMF-së" - së. Komuna Rahovec po të njëjtin aktivitet e ka bërë ri-shpalljen me specifikimet teknike të njëjta dhe diskriminuese. Autoriteti Kontraktues Kuvendi Komunal Rahovec me datën 08.10.2019 ne sistemin elektronik e-prokurimi ka bere Njoftimin për Kontratë për te njëjtin aktivitet për tenderin me Titull: FURNIZIM ME PAISJE MJEKESORE PER FIZIOTERAPI DHE LABORATO PER NEVOJA TE QKMF-se- RITENDERIM nr te prokurimit 62319-7651-1-2-1 për LOT 2: FURNIZIM ME PAJISJE MJEKËSORE PER LABORATOR PER NEVOJA TË QKMF-, pas te gjithë hapave ligjor ne kemi deponuar pran OSHP-se me datën 22.10.2019 ANKESE-ne tone lidhur me shkeljet e Autoritetit Kontraktues lidhur me pretendimet tona.

Me datën: 04.11.2019 OSHP-sjell Njoftim me nr. 730/19 ku vjen në përfundim se :

Ankesa jone është vlerësuar e Bazuar dhe kërkohet nga Autoriteti Kontraktues qe te beje ANULIMIN e Aktivitetit te prokurimit dhe te hartoj specifika teknike konform LPP-se duke krijuar mundësi sa me te mire për te gjithë Operatorët e interesuar Ekonomik dhe tenderuesit.

Me datën 29.11.2019 Autoriteti Kontraktues KUVENDI KOMUNAL RAHOVEC, bene publikimin e njoftimit për Kontratë Lidhur me te njëjtin Aktivitet te prokurimit për tenderin me Titull: FURNIZIM ME PAISJE MJEKESORE PER FIZIOTERAPI DHE LABORATOR PER NEVOJA TE QKMF-se- RITENDERIM, me nr. te prokurimit: 623-19-9204-1-2-1, me nr. te brendshëm 623-19-064-1-2-1 për LOT 2: FURNIZIM ME PAJISJE MJEKËSORE PER LABORATOR PER NEVOJA TË QKMF.

Pas shikimi te detajuar te Specifikave Teknike te publikuara ne kemi hasur ne parregullsitë e njëjta siç kanë qene ne 2 aktivitet paraprak lidhur me Specifikat Favorizuese dhe Diskriminuese.

Autoriteti Kontraktues ne këtë Rast Komuna e Rahovecit, nuk ka bere NDRYSHIME-apo dhe Gjeneralizim te Specifikave Teknike por ato qe kanë qenë ne aktivitet paraprake me disa dallim minimale që nuk përmban ndryshimi ka publikuar serish në këtë aktivite".

Paneli shqyrtues konform ekspertit shqyrtues profesional konstaton se pretendimet e operatorit ekonomik ankues janë të bazuara sepse AK me rastin e ri tenderimit te këtij aktiviteti të prokurimit pas njoftimit të PSH 730/19 datës 04.11.2019 me te cilin është kërkuar nga AK që ky aktivitet të ri tenderohet dhe specifikat e tenderit të korrigjohen konform LPP-së, AK me rastin e ri tenderimit në këtë aktivitet të prokurimit ka korrigjuar specifika teknike lidhur me LOT 2: Furnizim me pajisje mjekësore për laborator për nevoja të QKMF-së" vetëm ne disa pika si vijon:

Në tabelë janë përshkruar shkurtimisht vetëm specifikat e reja (korrigjuara) dhe specifikat e vjetra:



Specifikat e reja (pjesa e korrigjuara) Specifikat e vjetra (si kane qenë në procedurën e kaluar)

Përputhje deri në 440 teste/h Përputhje deri në 450 teste/h

Përputhje I.S.E only 195 testes/h Throughput Chemistry + I.S.E: 245 testes/h Përputhje I.S.E only 200 testes/h Throughput Chemistry + I.S.E: 250 testes/h

Profili deri ne 480 teste ne memorie Profili deri ne 500 teste në memorie

Sirtari i reagnesit-min 23 max 26 pozicioni Sirtari i reagnesit-24 pozicioni

Sirtari i mostres-min 58 max 62 pozicioni Sirtari i mostres-62 pozicioni

Koha e llambes rreth min 1800 orë Koha e llambes rreth 2000 orë

6 min GB DD R4 2400 MHZ 8 min GB DD R4 2400 MHZ

Ndërsa pjesa tjetër e specifikave teknike te përshkruara në dosjen e tenderit të këtij aktivitetit të prokurimit janë identike me specifikacionin i cili ka qenë në dosjen e tenderit te aktivitetit të prokurimit i cili është anuluar me qëllim që të korrigjohen specifikat teknike.

Paneli shqyrtues konform eksperti shqyrtues profesional konstaton se AK ka bërë disa korrigjime të specifikacioneve por te cilat janë vetëm korrigjime minore sepse përsëri komplet specifikacioni teknik respektivisht po thuajse mbi 90% e këtyre specifikave teknike janë identike me specifikat e pajisjes “Dialab Autolyser ISE” të kompanisë prodhuese “DIALAB” me adresë “Gesellschaft m.b.H. IZ NOE-Sued Hondastraße, Objekt M55, A-2351 Wr. Neudorf, Austria”.

Paneli shqyrtues konstatimin e lartcekur e bazon në faktin se eksperti shqyrtues profesional ka bërë hulumtimin/verifikimin e specifikacionit në fjalë edhe përmes adresave elektronike :<https://www.dialab.at/en/products/instruments/clinical-analysers/autolyser-ise/>, si dhe <https://www.dialab.at/nc/en/products/instruments/instrument/clinical-analysers/autolyserise/>, ku pas qasjes në këto adresa është konstatuar se specifikacioni teknik i pajisjes “Dialab Autolyser ISE” është mbi 90% identik me specifikacionin teknik të përshkruar nga AK për pajisjen mjekësore për laborator për nevoja të QKMF-së”.

Andaj paneli shqyrtues konform eksperti shqyrtues profesional konstaton se përgatitja e specifikacioneve teknike në këtë mënyrë në rastin konkretë është në kundërshtim me paragrafin 2 të nenit 28 të LPP-së ku thuhet : “Autoriteti kontraktues do t'i përpilojë specifikimet teknike në atë mënyrë që ato të jenë në përputhje me qëllimin e prokurimit dhe të drejtuara drejt sigurimit të qasjes sa më të mirë për të gjithë operatorët e interesuar ekonomik dhe tenderuesit. Autoriteti kontraktues është veçanërisht i ndaluar që të hartojë specifikime teknike që favorizojnë ose diskriminojnë një ose më shumë operatorë ekonomik”.

Si dhe në kundërshtim me paragrafin 20.4 të RRUOPP ku thuhet: “Specifikimet /TER do të jetë e qartë, e saktë dhe precize dhe duhet të mos paraqet kufizime të panevojshme, në mënyrë që të mos kufizohet konkurrenca. Ato duhet të përkufizohen në mënyrë që mos të krijojnë dyshime rreth natyrës së mallrave, punëve ose shërbimeve të kërkuara”.

Paneli shqyrtues konstaton se AK për aktivitetin e prokurimit në fjalë dosjen e tenderit e ka përgatitur në kundërshtim me nenin 27 , 28 dhe 7 të LPP-së, po ashtu AK nuk e ka zbatuar në tërësi rekomandimin e panelit shqyrtues të dhënë me njoftimin PSH nr.730/19 të datës 04.11.2019.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi, duke e aprovuar si të bazuar ankesën e OE ankues dhe duke e anuluar Njoftimin për kontratë të AK-së.

#### **KËSHILLË JURIDIKE:**

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimin të këtij vendimi.

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues  
z. Goran Milenković



#### **Vendimi t'i dorëzohet:**

1x1 AK- Kuvendi Komunal Rahovec

1x1 OE- Ntsh “AtomMed”

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.